

TAKIMI I PARË 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i parë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua në datë **20.03.2025**.

Mbledhja u fokusua në: prezantimin e gjetjeve të studimit: *“Ndikimi i digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*, validimin e standardit të profesionit: *“Menaxher i mesëm në agroturizëm”* dhe validimin e standardit të kualifikimit profesional: *“Agroturizëm”*, niveli IV në KSHK.

Në pjesën e parë të takimit u prezantua një studim i zhvilluar nga UNDP Albania mbi *“Ndikimi i digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*. Përfaqësuesja e UNDP-së informoi se, studimi ishte fokusuar në tre sektorë kryesorë: turizëm, energji dhe TIK, si dhe ishte realizuar mbi bazën e një ankete me 100 kompani, prej të cilave 50 i përkisnin sektorit të turizmit. Rezultatet e studimit treguan se shumica e kompanive renditeshin në nivelin e dytë të digjitalizimit, me tendencë pozitive zhvillimi, ndërkohë që një pjesë e kompanive turistike kishin arritur nivelin e tretë të digjitalizimit. Përfaqësuesja e UNDP-së informoi se, sektori i turizmit shfaqte motivim për t'u digjitalizuar më tej, por mbeteshin sfida: mungesa e njohurive mbi teknologjitë e avancuara, ekspozimi i kufizuar ndaj profesioneve digjitale dhe modelet e biznesit digjital. Si nevojë u theksua rritja e njohurive dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit të turizmit dhe atij të TIK-ut.

Pjesa e dytë e takimit u përqëndrua në validimin e dokumenteve. Sekretariati Teknik prezantoi anëtarët me funksionet dhe detyrat e standardit të profesionit: *“Menaxher i mesëm në agroturizëm”*. Gjatë diskutimeve të anëtarëve, u bënë ndryshime të vogla në pak detyra, të cilat u reflektuan në draft-in final. Në përfundim të diskutimeve u validua standardi i profesionit me ndryshimet e dakordësuara.

Pas validimit të standardit të profesionit, Sekretariati Teknik prezantoi standardin e kualifikimit profesional: *“Agroturizëm”*, niveli IV në KSHK. Sekretariati Teknik prezantoi njësitë e të nxënit dhe peshat specifike në % për çdo njësi të nxëni. Anëtarët validuan standardin e kualifikimit profesional pa ndryshime.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U validua me ndryshime të vogla standardi i profesionit: *“Menaxher i mesëm në agroturizëm”*.
- U validua pa ndryshime standardi i kualifikimit profesional: *“Agroturizëm”*, niveli IV në KSHK.